



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 3446/ prot.

Data: 02.06.2026

VENDIM

Nr. 239, Datë 02.06.2026

Bazuar në pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 845, datë 03.07.2025, "Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional", në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, paraqiten të dhënat si më poshtë:

1. **Emri i ofruesit të AFP-së:** Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano", Gjirokastrë
2. **NIPT :** L52527791P.
3. **Organizimi i institucionit:** Shkollë e mesme profesionale publike.
4. **Lloji i ofruesit të AFP-së:** Shkollë e mesme profesionale

Pasi mora në shqyrtim raportin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit, të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

Konstatohet se:

- a) procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara për këtë proces;
- b) vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c) raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

Akreditimin e Ofruesit Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano", Gjirokastrë për kualifikimet profesionale II -IV të KSHK-së si më poshtë vijon:

1. "Shërbime mjetesh transporti" Niveli II i KSHK-së, M-II-25.
2. "Shërbime elektro-auto" Niveli III i KSHK-së, M3-III-22.
3. "Shërbime mjetesh transporti" Niveli IV i KSHK-së, M-IV-23.
4. "Elektroteknikë" Niveli II i KSHK-së, E-II-21.
5. "Instalime elektrike, civile dhe industriale" Niveli III i KSHK-së, E1-III-21.
6. "Elektroteknikë" Niveli IV i KSHK-së; E-IV-25.
7. "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" Niveli II i KSHK-së; T-II-25.
8. "Mbështetje e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit" Niveli IV i KSHK-së; T2-IV-21.
9. "Termohidraulikë" Niveli II i KSHK-së; V-II-20.
10. "Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse", Niveli III i KSHK-së; V2-III-21.
11. "Termohidraulikë" Niveli IV i KSHK-së; V-IV-23.
12. "Hoteleri-Turizëm" Niveli II i KSHK-së; G-II-22.
13. "Shërbime në hotel dhe restorant " Niveli III i KSHK-së; G5-III-24.
14. "Hoteleri-Turizëm" Niveli IV i KSHK-së; G-IV-25.

Afati i akreditimit fillon me datën e daljes së këtij vendimi dhe ka vlefshmëri 4 vjet.

Ofruesi i AFP-së duhet të plotësojë rekomandimet e raportit përfundimtar të akreditimit referuar shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi, në përputhje me propozimin përkatës nr.101/5, datë 20.04.2026, ardhur nga AKAFPK-ja.

Ofruesi i AFP-së t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kuadrit ligjor në fuqi, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe për monitorimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të akreditimit, sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Delina Ibrahimaj

